



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Medplus shpk” të datës 17.06.2026 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “45 Furnizim me barna dhe material shpenzues për nevojat e KPSH-së” me nr. të prokurimit 616-26-3368-1-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET si pjesërisht e bazuar** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Medplus shpk” të datës 17.06.2026 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “45 Furnizim me barna dhe material shpenzues për nevojat e KPSH-së” me nr. të prokurimit 616-26-3368-1-1-1.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të publikoj Formularin për Korigjimin e Gabimeve në Njoftimet e Publikuara përmes të cilit do të bëjë korigjimin e kërkesave mbi kapacitetin teknik dhe profesional në dosjen e tenderit sipas të gjeturave të evidentuara më poshtë në këtë vendim.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik “Medplus shpk” (tutje “parashtruesi”) me datë 17.06.2026 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “45 Furnizim me barna dhe material shpenzues për nevojat e KPSH-së” me nr. të prokurimit 616-26-3368-1-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

Pretendimi 1:

Në dosje të tenderit është kërkuar "Kërkesa 7. Operatori Ekonomik ofertues se bashku me ofertë, duhet që të sjellë nga një moster për lloj te produktit.(poz 46,47,48,49,67,68,158 dhe 159) (Mostrat duhet të dorzohen para hapjes së tenderit)", ndërsa tek dëshmia e kërkuar dokumentare është kërkuar "Dëshmia 7. Mostrat e kerkuara duhet te dergohen para ose ne daten dhe ne kohen e ofertimit. Pas dates dhe kohes se caktuar ne dosjen e tenderit per ofertim mostrat e derguara nuk pranohen".

46."Dezinfektues, steril gel, me mekanizëm shtypës, 1000ml, për duar 100 g tretësirë përmban përbërësit aktivë të mëposhtëm: 89.0-89.2 g Etanol 96% " 47."Dezinfektues, steril lengshem, me mekanizëm shtypës, 1000ml, për duar, 100 g tretësirë përmban përbërësit aktivë të mëposhtëm: 89.0-89.2 g Etanol 96% " 48."Dezinfektues, steril gel, me mekanizëm shtypës, 500ml, për duar, për duar 100 g tretësirë përmban përbërësit aktivë të mëposhtëm: 89.0-89.2 g Etanol 96% " 49."Dezinfektues, steril lengshem, me mekanizëm shtypës, 500ml, për duar 100 g tretësirë përmban përbërësit aktivë të mëposhtëm: 89.0-89.2 g Etanol 96% " 67."Dezinfektues per pajisje mjekesore liter (11-12 g etandial, 0.4-0.5 g pentanedial, 7-8kg klorur didecildimetilamoniumi Ekscipientët: Komponime surfaktante, parfumi, ngjyrues, frenues korrozioni" 68.Dezinfektues per siperfaqe liter, 24.5-24.95g Ethanol (94 %), 34-35 g Propan-1-ol Autoriteti Kontraktues në specifikimet teknike për pozicionet e lartcekura me nr. 46, 47, 48, 49, 67 dhe 68 ka përcaktuar në mënyrë tepër specifike përbërjen dhe intervalet e sakta të substancave aktive, duke kufizuar konkurrencën dhe njëkohësisht duke e orientuar këtë aktivitet të prokurimit drejt produkteve të prodhuesve të caktuar. Për pozicionet 46, 47, 48 dhe 49 është kërkuar që 100 g tretësirë të përmbajnë 89.0-89.2 g Etanol 96%, ndërsa për pozicionet 67 dhe 68 janë përcaktuar intervale shumë të ngushta të substancave aktive dhe përbërësve tjerë. Këto specifikime nuk janë formuluar në bazë të performancës, efektivitetit apo rezultatit të kërkuar dezinfektues, por në bazë të formulimeve specifike që i përshtaten produkteve të prodhuesve të caktuar, ndërsa një veprim i tillë ju pamundëson ofertimin kompanive të cilat posedojnë produkte ekuivalente/ngjashme, përkatësisht produkte me përbërje edhe më të mirë se sa produktet të cilat janë kërkuar nga AK-ja. Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh/WHO) në udhërrëfyesit e saj për dezinfektuesit e duarve rekomandon formulime efektive me përmbajtje të etanolit në intervale të përafërta prej **60% deri 80%**, duke vlerësuar efektivitetin dezinfektues dhe jo domosdoshmërisht përqindje identike apo intervale kaq të ngushta si intervalet e përcaktuara në dosjen e tenderit nga ana e AK-së. Prandaj nga ky fakt kuptohet qartë se kërkesat e AK-së të vendosura tek specifikimet teknike pa tolerancë fare nuk janë të domosdoshme për funksionin e këtyre produkteve dhe njëkohësisht të njëjtat specifika ju pamundësojnë ofertimin operatorëve ekonomik të interesuar për ofertim në këtë aktivitet të prokurimit të cilët posedojnë produkte të ngjashme me efektivitet të njëjtë apo ekuivalent. Prandaj kërkojmë që të ndryshohen specifikimet teknike sipas rekomandimeve të OBSh-së, njëkohësisht duke u lejuar ofertimi **me produkte ekuivalente**, me qëllim të hapjes së konkurrencës. Gjithashtu, vetëm për këto pozicione dhe pozicionet nr.158 dhe 159 autoriteti kontraktues ka kërkuar edhe dorëzimin e mostrave para hapjes së tenderit, e cila kërkesë konsiderojmë që është e panevojshme dhe e paarsyeshme. Mostrat janë të panevojshme për faktin se mostrat janë kërkuar vetëm për këto produkte, ndërsa nuk janë kërkuar për produkte shumë më të rëndësishme dhe më të ndjeshme nga aspekti mjekësor, **siç janë insulinat, imunoglobulinat, infuzionet, gjilpërat, kanillat dhe sistemet e infuzionit**. Nëse AK-ja nuk e ka parë të nevojshme të kërkojë mostra për produkte që përdoren drejtpërdrejt te pacientët dhe që kanë rëndësi

shumë më të madhe për trajtimin e tyre, atëherë për ne nuk është e qartë pse një kërkesë e tillë është vendosur pikërisht për këta dezinfektues. Po ashtu duhet sqaruar faktin se, mostrat janë kërkuar vetëm për pozicionet për të cilat janë përcaktuar specifika shumë të ngushta, gjë që tregon qartë se këto kërkesa favorizojnë OE që i posedojnë pikërisht produktet me përbërjet e kërkuara nga AK-ja. Për këtë arsye kërkojmë që kërkesa për dorëzimin e mostrave për këto pozicione të largohet në tërësi, ose të kërkohej për të gjithë produktet mostrat, sepse në këtë mënyrë po favorizohen OE të caktuara. Nëse Autoriteti Kontraktues vlerëson se specifikimet teknike për pozicionet nr. 46, 47, 48, 49, 67 dhe 68 duhet të mbesin të pandryshuara, atëherë kërkojmë që këto pozicione të ndahen në lot të veçantë. Specifikimet e kërkuara i përshtaten prodhuesve të caktuar dhe mund të plotësohen vetëm nga operatorët ekonomikë që posedojnë autorizimet dhe dokumentacionin përkatës të këtyre prodhuesve. Si pasojë, shumë operatorë ekonomikë që mund të ofertojnë për shumicën e artikujve të këtij aktiviteti nuk kanë mundësi të ofertojnë për shkak të këtyre pak pozicioneve. Prandaj, ndarja e tyre në lot të veçantë do t'u mundësonte operatorëve ekonomikë të ofertojnë për produktet tjera pa u penguar nga këto kërkesa specifike.

Pretendimi 2: Lidhur me pozicionet nr. 158 "X-ray digital film 20x25cm per printer compatible me printerin Carestream" dhe nr. 159 "X-ray digital film 35x43cm per printer compatible me printerin Carestream", kërkojmë që këto produkte të ndahen në një lot të veçantë. Këto produkte janë specifikuar në mënyrë të tillë që duhet të jenë kompatible me printerin Carestream, ndërsa sipas njohurive tona të tregut, kompania Medika është operatori i vetëm ekonomik i autorizuar në Kosovë për furnizimin me këto produkte. Andaj kur kemi parasysh këtë fakt, sqarojmë se përfshirja e këtyre dy pozicioneve në të njëjtin lot me barna dhe materiale të tjera shpenzuese ua pamundëson pjesëmarrjen operatorëve ekonomikë të tjerë të interesuar për ofertim në këtë aktivitet të prokurimit dhe të cilët mund të ofertojnë për shumicën e artikujve të këtij aktiviteti të prokurimit, por nuk posedojnë autorizimin për këto produkte. Prandaj kërkojmë që pozicionet nr. 158 dhe 159 të ndahen në një lot të veçantë, në mënyrë që kërkesa e vetëm këtyre dy artikujve të tillë të mos ju pamundësojë ofertimin OE të interesuar për ofertim për pjesën tjetër të produkteve të kërkuara.

Pretendimi 3: Tek Aneksi 7 – Lloji i mekanizimit dhe pajisjeve, është kërkuar: Kamion 7.5T me rampe-2 copë. Kjo kërkesë sqarojmë se nuk është e nevojshme për këtë aktivitet të prokurimit dhe e njëjta kufizon konkurrencën, ndërsa favorizon OE të caktuar të cilët posedojnë kamionët e kërkuar me tonazhën e lartcekur, e të cilët siç e cekëm nuk kanë të bëjnë fare me natyrën e furnizimeve në këtë aktivitet të prokurimit. Kur kemi parasysh faktin se furnizimet nuk realizohen në një dërgesë të vetme, por në disa dërgesa të ndara dhe sipas nevojave të AK-së, atëherë mjetet transportuese të tipit Pikap-KOMBI me kushte të përshtatshme transporti (p.sh. me klimë/kontroll temperature dhe kushte të sigurta për ruajtjen e mallrave) janë të mjaftueshme për realizimin e kontratës në pajtim me kushtet e saj. Gjithashtu, kërkojmë të na sqarohet nëse kamionët 7.5T të kërkuar kanë mundësi reale të qasën dhe të kryejnë furnizimet në të gjitha lokacionet ku është paraparë dorëzimi i mallit, duke pasur parasysh madhësinë dhe peshën e tyre, si dhe kushtet e qasjes në terren. Sa për sqarim kamionët e tonazhit 7.5T përdoren kryesisht në sektorin e ndërtimitarisë dhe logjistikës së rëndë, për transport të materialeve ndërtimore, mallrave në paleta dhe furnizime në sasi të mëdha për depo dhe qendra shpërndarëse dhe nuk janë adekuat për transport të barnave, pasi që edhe nuk kanë klimë. Për shkak të madhësisë dhe peshës së tyre, këto mjete zakonisht operojnë në rrugë kryesore dhe objekte me infrastrukturë të përshtatshme për ngarkesa të rënda, dhe jo gjithmonë kanë qasje të lehtë në ambiente më të vogla apo brenda institucioneve. Prandaj sqarojmë se për furnizime të natyrës së këtij aktiviteti të prokurimit, ku

dërgesat janë të ndara dhe periodike, kërkesa për kamion 7.5T me rampë është e panevojshme për realizimin e kontratës dhe kufizon në mënyrë të panevojshme ofertimin e OE të interesuar për këtë aktivitet të prokurimit. Gjithashtu, duhet sqaruar fakti se ne kemi marrë pjesë në një procedurë tjetër të prokurimit të zhvilluar nga SHSKUK për furnizim me NaCl 0.9% 500 ml në sasi rreth 1.2 milion njësi, ku pavarësisht volumit shumë të madh të furnizimit në atë rast, në dosjen e tenderit nuk ka pasur kërkesa për posedim të kamionëve të tonazhit 7.5T me rampë dhe kontrata normalisht që është kryer pa kamionë. Kjo tregon se një kërkesë e tillë nuk është standarde dhe nuk është e domosdoshme për realizimin e furnizimeve të këtij lloji, por është favorizim i hapur ndaj OE të caktuar të cilët posedojnë pajisjet e kërkuara me tonazhën e saktë siç i ka kërkuar AK-ja. Me këto kërkesa, jo që nuk mund të ketë trajtim të barabartë të operatorëve ekonomik por do të ketë diskriminim të hapur dhe përcaktim të fituesit qysh në start të këtij aktiviteti të prokurimit, pa konkurrencë të hapur. Paragrafi 6 i dispozitës së nenit 7 parasheh qartë : Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit”. Me këto kërkesa nuk mundësohet pjesëmarrje e gjerë e operatorëve ekonomik, por në këtë mënyrë është kufizuar tej mase konkurrenca dhe këto kërkesa janë drejtpërdrejtë jo në harmoni me lëndën e prokurimit, sepse kur kufizohet konkurrenca me kërkesa të pa nevojshme atëherë edhe çmimi ofertues i operatorëve ekonomik të favorizuar automatikisht është shumë më i lartë sepse nuk kanë konkurrencë dhe faktikisht determinohet çmimi nga ana e autoritetit kontraktues në bazë të kërkesave të dosjes së tenderit. Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe kundërshtimet tona që u cekën më lartë, rezulton se dosja e tenderit nuk është përpiluar në harmoni me nenin 27 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk janë marr parasysh as neni 17.17 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik ku shkruan qartë që “Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë që nuk: Kufizon konkurrencën në mesin e OE, ose Diskriminon kundër ose vepron në favor të një ose më shumë OE-ve”. Kërkesat që u kundërshtuan më lartë, janë shumë favorizuese/diskriminuese dhe njëkohësisht ua mbyllin dyert e ofertimit shumë kompanive me eksperiencë në këtë fushë dhe gjithashtu këto kërkesa bien në kundërshtim edhe me nenin 25.4 të Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik, ku shkruan qartë se “Gjatë përcaktimit të kërkesave minimale për kualifikim, AK do të kushtoj rëndësi të veçantë zhvillimit të OE dhe do të formuloj kërkesat minimale të kualifikimit në mënyrë që nuk përjashton OE të themeluar rishtazi të cilët posedojnë aftësi të arsyeshme dhe të mjaftueshme ekonomike, financiare dhe/ose teknike”. Me këto kërkesa, jo vetëm që nuk i është kushtuar rëndësi operatorëve ekonomik të ri, por iu është kufizuar konkurrenca, prandaj duhet ndryshuar/larguar kërkesat e lartcekura që të mundësohet pjesëmarrje më e gjerë e operatorëve ekonomik në këtë aktivitet të prokurimit dhe të merret parasysh edhe dispozita e lartpërmendur (25.4 të Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik). Pra, në vend se të merret parasysh edhe zhvillimi i operatorëve ekonomik të rinjë, janë diskriminuar hapur edhe operatorët ekonomik tjerë, me më shumë përvojë në këtë fushë siç është ky aktivitet i prokurimit. Pra është kufizuar konkurrenca.

Lidhur me pretendimet ankimore, pas analizimit me kujdes të kërkesave përkatëse të DT, është konstatuar se kërkesat për mostra dhe kërkesa për kamion 7.5 ton janë kërkesa të panevojshme andaj duhet të largohen nga DT. Ndërsa sa i përket kërkesës për ndarje në lot të posaçëm të poz. 158 dhe 159, kjo kërkesë e parashtruesit do të shqyrtohet dhe do të vendoset në konsultim me njësinë kërkuese.

Vlen të citohet neni 7 paragrafi 2 të LPP përmes të cilit përcaktohet se "Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatorëve ekonomik".

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pjesërisht pretendimet e tij ankimore. Prandaj kërkesa e tij për rishqyrtim është miratuar si e bazuar pjesërisht.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP. Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 26.06.2026



Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimi të këtij vendimi.